

**VENDIM**  
**Nr. 360, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 491, DATË 21.7.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT TË QENDRAVE SHËNDETËSORE NË BASHKINË KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI ZBATUESE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 491, datë 21.7.2022, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/2 Bashkisë Kurbin, në buxhetin e vitit 2024, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 155 147 100 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dyzet e shtatë mijë e njëqind) lekë pa TVSH, që do të përballohet nga shpenzimet e buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) 48 933 660 (dyzet e tetë milionë e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të qendrës shëndetësore në fshatin Gjorëm, Njësia Administrative Mamurras;

b) 24 803 600 (njëzet e katër milionë e tetëqind e tre mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të qendrës shëndetësore Sanxhak-Laç, Njësia Administrative Laç;

c) 61 126 160 (gjashtëdhjetë e një milionë e njëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të qendrës shëndetësore në qytetin e Mamurrasit, Njësia Administrative Mamurras;

ç) 5 065 200 (pesë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të qendrës shëndetësore në qytetin e Laçit, Njësia Administrative Laç;

d) 15 218 480 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të qendrës shëndetësore në Fushë-Milot, Njësia Administrative Milot.”;

b) Në pikën 3, fjalët “ sipas pikave 1, 2 dhe 2/1 ...” zëvendësohen me “... sipas pikave 1, 2, 2/1 dhe 2.2 ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**